

## **NJOFTIM**

Universiteti “Ismail Qemali” Vlorë, bazuar në Urdhërin Nr.125 datë 09.12.2022 të Rektorit, *shpall* njoftimin për konkurim të hapur, për vendin e lirë të punës në Universitetin “Ismail Qemali” Vlorë:

**Personel ndihmësakademik me karakter mësimor, me angazhim me kohë të plotë, në pozicionin:”Specialist i Qendrës Kërkimore Shkencore të Shëndetit Publik në Fakultetin e Shëndetit”.**

### **Detyrat dhe përgjegjësitë**

- Mbledhja dhe ruajtja e bazës së të dhënave (data repository) të aktiviteteve kërkimore – shkencore të QKSHSHP dhe Grupeve kërkimore-shkencore të Fakultetit të Shëndetit në përputhje me rregulloren e qendrës dhe rregullat e institucionit.
- Asistencë në procedurat e aplikimit në Agjencinë e Sigurimit të Cilësisë së Kujdesit Shëndetësor dhe Shoqëror (ASCKSHSH) për akreditimin e aktiviteteve edukative dhe kërkimore-shkencore të FSH.
- Asistencë në procedurat e koordinimit me institucione të tjera dhe aplikimit të projekteve infrastrukturore dhe projekteve të kërkim-zhvillimit në AKKSHI dhe BE të FSH.
- Mbajtja e kontakteve me partnerët institucionalë në programet bashkëpunuese ERASMUS+ dhe Horizon Europe.
- Asistencë në dizenjimin dhe koordinimin e aktiviteteve promovionale të parashikuara nga qendra për rritjen e ndërgjegjësimit dhe promovimin e shëndetit në komunitet.
- Ndjekja e procedurave të tenderimit për blerjen e bazës materiale për zhvillimin e aktiviteteve promovionale dhe kërkimore-shkencore.
- Kryhen hulumtime të vazhdueshme për përditësime ligjore në fushën e kërkimeve shëndetësore dhe konsulton aktet nënligjore ose rregulloret që lidhen me shëndetësinë.
- Dokumentimi dhe ruajtja e bazës së të dhënave të aktiviteteve promovionale shëndetësore.
- Aplikimi i metodave statistikore në përpunimin e database-ve të projekteve kërkimore të QKSHSHP dhe Grupeve kërkimore-shkencore të Fakultetit të Shëndetit dhe përdorim të tyre në fushën e shëndetit.
- Hartimi i të gjitha shkresave të cilat i ngarkohen nga Drejtuesi i Qendrës.
- Hartimi i raportit vjetor për veprimtaritë kërkimore-shkencore dhe projektet.

### **Kritere të përgjithshme që duhet të plotësoj/në kandidati/ët**

- a) Të jetë shtetas/e shqiptar/e.
- b) Të zotëroj gjuhën shqipe, të shkruar dhe të folur.
- c) Të ketë zotësi të plotë për të përpunuar.
- d) Të jetë i aftë nga ana shëndetësore për të kryer detyrën përkatëse.
- e) Të zotëroj aftësitë e nevojshme profesionale për vendin e punës për të cilin konkuron;

- f) Të ketë aftësi të mira komunikuese etiko-profesionale, të bashkëpunimit dhe të punës në grup me kolegët dhe eprorët;
- g) Të njohi një prej pesë gjuhëve të Bashkimit Europian: anglisht, frëngjisht, gjermanisht, italisht, spanjisht, të çertifikuara sipas testeve të njohura nga MASR. Nëse kandidati ka fituar një diplomë të një programi studimi të kryer në një nga këto gjuhë, diploma e fituar shërben si dëshmi për plotësimin e këtij kriteri;
- h) Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë të Gjykatës për kryerjen e një vepre penale me dashje si dhe të mos jetë person nën hetim për vepra të rënda penale;
- i) Kandidati nuk duhet të ketë patur background negativ në eksperiencat e mëparshme në punë dhe të mos jenë marrë ndaj tij masë disiplinore “largim nga puna”;
- j) Të mos jetë në proces gjyqësor me Universitetin “Isamil Qemali” Vlorë;
- k) Të mos ketë vepruar ose propaganduar në drejtim të prishjes së imazhit të Universitetit “Ismail Qemali” Vlorë dhe autoriteteve/organeve drejtuese të saj, në median vizive dhe/apo të shkruar, rrjetet sociale etj.

### **Kritere të veçanta**

1. Studime të larta në fushat:
  - Shëndet Publik
  - Mjekësi
  - Infermieri të Përgjithshme
  - Infermieri Mami
2. Eksperiencë pune të mëparshme në sistemin shëndetësor - minimalisht 1 vit.
3. Të mos kenë pasur masa disiplinore të largimit nga puna në universitet/institucion shëndetësor/kërkimor apo të kenë patur më parë vlerësime negative të performancës institucionale.

### **Kriteret shitesë**

1. Aftësi të shkëlqyera kërkimore-shkencore.
2. Aftësi në planifikim dhe organizim të aktiviteteve edukative/trajnuese.
3. Njohja e Gjuhës Angleze (përderisa komunikimi midis partnerëve në bashkëpunimet ndërkombëtare është në këtë gjuhë).
4. Aftësi të mira kompjuterike (kapacitet për të hartuar raporte në kompjuter dhe analizë të dhënash).
5. Aftësi të mira në përdorimin e paketës Microsoft Office, aplikimeve Ueb dhe platformave të kërkimit në Internet.
6. Të kenë aftësi të përpilojnë, analizojnë dhe përgatisin raporte dhe të dhëna teknike që lidhen me fushën e veprimtarisë.
7. Të kenë aftësi të mira komunikuese dhe të jenë të motivuar për të punuar në grup.
8. Të jenë të aftë të garantojnë standartin e cilësisë dhe efikasitetin në punë.

## Dokumentacioni i kërkuar

- a) Letër interesi për pozicionin (formulari i aplikimit gjendet në adresën [www.univlora.edu.al](http://www.univlora.edu.al))
- b) Jetëshkrim/ Curriculum Vitae;
- c) Diploma/t universitare (kopje e noterizuar);
- d) Lista e notave të studimeve universitare (origjinal);
- e) Tituj akademik ose grada shkencore (kopje e noterizuar);
- f) Dëshmi të kualifikimeve, trajnimeve apo specializimeve (kopje e noterizuar);
- g) Artikuj të botuar, projekte shkencore, etj;
- h) Libreza e punës ose vërtetim zyrtar për periudhën kohore të punësimit nga organi tatimor (origjinal ose kopje të noterizuar);
- i) Dy rekomandime nga profesor/profesor i asociuar ose/dhe punëdhënësi i fundit;
- j) Referenca që provojnë vlerësimet pozitive në punë;
- k) Dëshmi e njohjes së gjuhës së huaj (origjinal ose kopje e noterizuar);
- l) Dëshmi e njohjes së kompjuterit (origjinal ose kopje e noterizuar);
- m) Raport mjekësor për aftësinë në punë, lëshuar 3 muajt e fundit (origjinal);
- n) Vërtetim i gjëndjes gjyqësore (dokument i lëshuar nga Ministria e Drejtësisë, Gjykata e Rrethit Gjyqësor dhe Prokuroria e Rrethit Gjyqësor ku kandidati ka vendbanimin);
- o) Letërnjoftimi ID (fotokopje);

### Shënim:

*Diplomat, çertifikatat, gradat dhe titujt e fituar në institucione të huaja arsimore, të shoqërohen me çertifikatën e njehsimit, bazuar në nenin 92 të Ligjit nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e Arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë".*

## Mënyra e aplikimit

Dokumentat duhet të dorëzohen **vetëm nëpërmjet shërbimit postar** në adresën:



Universiteti "Ismail Qemali", Vlorë.

Drejtoria e Komunikimit dhe e Burimeve Njerëzore.

**Aplikim për punësim/pozicioni i punës:** *"Specialist i Qendrës Kërkimore Shkencore të Shëndetit Publik në Fakultetin e Shëndetit".*

Lagjia "Pavarësia", Rr. "Kosova" 9400 Vlorë, Shqipëri.

## Afati për aplikim

- ✓ Afati për të aplikuar është 10 ditë kalendarike. Ky afat fillon nga dita e parë e shpalljes në faqen zyrtare të internetit të UV-së. (njoftimi u publikua në datën 09.12.2022 dhe afati përfundon në datën 19.12.2022).
- ✓ Dokumentacioni i dorëzuar në shërbimin postar pas datës 19.12.2022, do t'i kthehet aplikantit pa veprime.

### **Fazat në të cilën do të kalojë konkurimi**

- ✓ Konkurimi do të kryhet në dy faza: vlerësimi i dosjes dhe intervista e drejtëpërdrejtë e kandidatit.
- vlerësimi i dosjes parashikon verifikimin e dokumentave nëse kandidatët plotësojnë kushtet dhe kërkesat për vendin vakant, vlerësimin e arsimimit, përvojës në punë, trajnimet e kualifikimet e lidhura me fushën përkatëse si dhe vlerësimet pozitive;
- intervista e strukturuar me gojë;

### **Fusha e njohurive, aftësitë dhe cilësitë që do të vlerësohen në intervistë**

- Aftësitë komunikuese, bashkëpunuese etj.

### **Mënyra e vlerësimit të kandidatëve**

Struktura e ndarjes së pikëve të vlerësimit të kandidatëve, është si më poshtë vijon:

- 70 pikë për vlerësimin e dokumentacionit të dorëzuar, e ndarë në: 30 pikë arsimimi, 20 pikë përvojë pune, 10 pikë për trajnime apo kualifikime të lidhura me fushën përkatëse, 10 pikë për vlerësimet e rezultateve individuale në punë.
- 30 pikë intervista e strukturuar me gojë, ku, me një grup të njëjtë pyetjesh për të gjithë kandidatët, vlerësohen njohuritë, aftësitë dhe formimi i tyre.

### **Mënyra e njoftimit dhe komunikimit me kandidatët**

Komunikimi dhe njoftimi i kandidatëve do të mundësohet nga zyra e burimeve njerëzore të UV-së nëpërmjet postës elektronike.

**DREJTOR**

**ELOINA TOZAJ**